

Vendndodhja e projektit: Ohër
Data e projektit: 21 maj - 25 maj
Numri i pjesëmarrësve: 20
Gjuha e punës: maqedonisht dhe shqip

MË SHUMË INFORMACION PËR SHKOLLËN VERORE KUNDËR GJUHËS SË URREJTJES:

Këtë vit, CIDi organizon Shkollën e 10-të Kundër Gjuhës së Urrejtjes.

Shkolla verore kundër gjuhës urrejtjes do të mbledhë së bashku 20 të rinj. Grupi i të rinjve do të jetë i përzier, duke siguruar shumëllojshmëri bazuar në gjini, etni, vendndodhje gjeografike, fe, etj.

Temat kryesore që do të trajtohen janë:

- Ballafaqimi me gjuhën e urrejtjes;
- Gjuha e urrejtjes përmes internetit dhe
- Narrativet e kundërta

Qëllimi i përgjithshëm i Shkollës Verore Kundër Gjuhës së Urrejtjes është të stimulojë dhe mbështesë mekanizmat e ndryshëm për reagim efektiv ndaj gjuhës së urrejtjes në internet dhe për të rritur ndërgjegjësimin për format e ndryshme të ngacmimit në internet në mënyrë që të mbrojnë të drejtat e të gjithë qytetarëve.

Trajnimi do të bashkë-fasilitohet në të dy gjuhët në maqedonisht dhe shqip.

Metodat e arsimit joformal do të përdoren gjatë trajnimeve dhe seancat do të konsistojnë në punë në grupe, simulime, lojë me role dhe diskutime plenare që do të zgjeroj procesin dhe do të përshtaten me aftësinë e secilit student. Trajnimi do të zhvillohet jashtë Kumanovës në mënyrë që të krijohet një dinamikë më e mirë dhe ndërtimi i ekipit, duke marrë parasysh diversitetin në grup, por gjithashtu do të sigurojë hapësirë për të rinjtë që të lënë komunitetet e tyre dhe të mendojnë për çështjet dhe lidhjet në të.

PROFILI I PJESICMARRSVE:

- 15-20 vjet
- Të interesuar për temën
- Shume të motivuar
- Të gatshëm për të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet gjatë dhe pas kursit të trajnimit
- Thirrja është e hapur për pjesëmarrësit që vijnë nga zona e Komunës së Kumanovës, Lipkovës dhe Staro Nagoriçan.

AFATI PËR APLIKIM: 15.05.2021

Aspekti financiar:

Udhëtimi, akomodimi dhe ushqimi do të mbulohen 100% nga organizatorët.